

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2025

Periudha (Nëntor 2025)

Nr . Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfund imit të kërkesë s	Tarifa
31	29.10.2025	1.A ka bashkia Belsh një Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar? 2.Sa projekte ka zbatuar apo po zbaton bashkia Belsh nepermjet mekanizimit te Fondit Social per periudhen 2023-2025? Per kete periudhe percaktoni te ndare sipas viteve respektive 2023, 2024, 2025 titullin e projektit/eve, kohezgjatjen, vitin aktual ne te cilin ndodhet zbatimi i Fondit Social/projekti, vleren e perthithur te fondit per secilin projekt sipas viteve si dhe tipologjine e sherbimeve sociale qe ofrohen dhe kategorite e perfituesve. 3.Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023, 2024 dhe 2025? 4.A ka aplikuar Bashkia Belsh per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2025? 5.Sa ka qene vlera totale e miratuar nga MSHMS dhe e disbursuar per vitin 2025 dhe per cilat kategori sherbimesh jane perdorur?	05.11.2025	1.Bashkia Belsh ka një Plan Social, të miratuar me datë 29.12.2023. 2.Projekti që ka zbatuar dhe po zbaton ende Bashkia Belsh nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social për periudhën 2023-2025, është projekti i “Qendrës sociale Ditore Nderim Brezash”. Ky projekt është në vitin e pestë të zbatimit të tij, çdo vit aplikohet pranë MSHMS nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social për të përfituar mbështetje financiare. Qendra ofron pije, ushqim dhe shërbime fizioterapie, dhe përfitues të këtyre shërbimeve janë mosha e tretë. Vlera e përthithur e fondit për këtë projekt, për vitet 2023, 2024, 2025 është: viti 2023 = 5.923.977 lekë viti 2024 = 6.243.429 lekë viti 2025 = 8.273.900 lekë 3.Për të treja vitet 2023, 2024 dhe 2025, është përdorur 100% e fondit të përfituar. 4.Po, Bashkia Belsh ka aplikuar për të përfituar nga Fondi Social dhe është shpallur fituese në vitin 2025 për projektin e sipërpërmendur. 5.Vlera totale e miratuar nga MSHMS dhe e	E plotë	Pa pagesë

		6.A keni parashikuar ne buxhetin afatmesem 2026-2028 fonde per te mbajtur ne funksion sherbimet e ofruara ne territor si kontribut i bashkise, edhe pas perfundimit te financimit te Fondit Social? 7.Cilat jane kategorite e shtresave vulnerabel te identifikuara ne bashkine tuaj qe perfitojne aktualisht nga sherbimet sociale te ofruara nepermjet mekanizmit te fondit social?		disbursuar për vitin 2025 është 1.233.900 lekë, kjo vlerë është përdorur për kategorinë e moshës së tretë. 6.Po, kemi parashikuar në buxhetin afatmesëm 2026-2028 fonde për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor si kontribut i bashkisë, edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social. 7.Kategoria e shtresave vulnerabël të identifikuara në bashki që përfitojnë aktualisht nga shërbimet sociale të ofruara nëpërmjet mekanizmit të fondit social, është mosha e tretë.		
--	--	---	--	---	--	--